

RAPORTI PER FUNDIMTAR

I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

PËR

VLERËSIMIN E JASHTËM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT:

“MASTER SHKENCOR NË FINANCË – BANKË”

NË INSTITUCIONIN E ARSIMIT TË LARTË JO PUBLIK

“UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË”

Tiranë, Maj 2012

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm: Prof. Dr. Lavdosh ZAHO

Hyrje

Universiteti Mesdhetari i Shqipërisë (UMSH), pas akreditimit, nga Këshilli i Akreditimit dhe licensimit nga MASH gjatë muajit nëntor 2011, ka filluar “Masterin Shkencor në Financë Bankë” në të cilin kanë të drejtë të ndjekin studimet studentët dhe profesionistët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve. Për hartimin e këtij raporti, pas shqyrtimit të kujdesshëm të materialeve të vëna në dispozicion nga APAAL-i GVJ kreu paraprakisht edhe këto veprimtari:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe me përgjegjësit e departamenteve
- Takim me GVB duke bërë pyetje dhe diskutime me ta.
- Takim me stafin akademik (efektiv dhe me kontratë) për programet e studimit.
- Takim dhe vizita në sekretarinë mësimore, në zyrën e burimeve njerëzore dhe në zyrën e kurrikulave.
- Vëzhgim i mjediseve (auditoreve, laboratorëve, bibliotekës dhe shërbimeve për studentet, etj)
- Takim dhe intervista me studentët e programit përkatës,
- Takim përmbyllës me titullarin e institucionit.

Ky raport pasqyron vlerësimin e bërë për programin e studimeve “Master Shkencor në Financë – Bankë” të UMSH..

Përbërja e GVJ

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm për “Master Shkencor në Financë – Bankë” përbëhet si vijon:

- Prof. Dr. Lavdosh Zaho (kryetar)
- Prof. Dr. Vjollca Bakiu (anëtare)
- Prof Asoc. Dr., Manjola Naço (anëtare)
- Dr. Arian Qefalia (docent) (anëtar).

Parimet e Punës së GVJ kanë qenë:

- Besimi se, duke shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe duke ballafaquar njohuritë e marra nëpërmjet tyre me realitetin në institucion, do të të ndihmojë në akreditimin e këtij masteri dhe të jap edhe sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të programit.
- Vlerësimi të mbështetet kryesisht në dokumentat e paraqitura nga GVB dhe Institucioni ndërmjet të cilëve mund të përmendim: raportin e vetvlerësimit të brendshëm, programet (curriculat) e lëndëve e moduleve, etj.

Sikurse u përmend më sipër, programi i studimeve: “Master Shkencor në Financë Bankë” i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është në vitin e parë të tij. Kështu që, në këtë raport nuk mund të përfshihen

gjetje e konsiderata për ecurinë në të kaluarën. Gjetjet dhe vlerësimet e GVJ i përkasin vetëm vitit në vazhdim.

Tabela format për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit “Master Shkencor në Financë Bankë” i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë mbështetur në Standardet shtetërorë për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Institucioni ofron një program studimi të ciklit të dytë “Master Shkencor në Financë Bankë” të organizuar në module dhe dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit);
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit	Ky program studimi është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Duke u nisur nga fakti që sistemi bankar në Shqipëri është hallka më e kompletuar e sistemit financiar të vendit, mendojmë se program i studimit “Master Shkencor në financë bankë” ka patur mirë parasysh kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Programi “Master Shkencor në Financë Bankë” është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programi “Master Shkencor në Financë Bankë” pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.
Konkluzione: UMSH ofron një program studimesh të nivelit “Master Shkencor” i specializuar në fushën e Financë – Bankës që është në përputhje me misionin dhe qëllimin e këtij institucioni dhe në përshtatje me zhvillimin ekonomik dhe traditat kombëtare.	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Ky program masteri shkencor është në përshtatje me strategjinë për zhvillimin e gjithë institucionit

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p>	<p>Programi i studimeve Master Shkencor në Financë Bankë synon që, studentët që kanë një diplomë universitare “Bachelor”, të pajisen me njohuri më të thelluara teorike e praktike për një kërkim shkencor më të avancuar në fushën e financave në [ërgjithësi dhe të bankave në veçanti</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Programi synon të zgjerojë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve në fushën e specialitetit.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>Mendojmë se ky program studimesh “Master i shkencave në Financë –bankë” i pajis studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të këtij programi studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi. Për këtë dëshmojnë lëndët e përfshira, mënyra e organizimit të programit, etj.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Ky program i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale të cilat përfitohen dhe zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p>Programi krijon baza të qëndrueshme njohurish që mundësojnë kryerjen e studimeve të ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Ky kriter nuk është për Masterin Shkencor</p>
<p>Konkluzione: Programi i studimeve Master i shkencave në Financë – Bankë është hartuar në përshtatje me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe krijon baza të qëndrueshme njohurish për vazhdimin me sukses të ciklit të tretë të studimeve.</p>	
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Përmbajtja e këtij programi studimesh bashke me dokumentacionin tjetër që e shoqeron është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>
<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Emërtimi i këtij programi studimi është në përputhje me e nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Megjithatë, është e nevojshme të mënjanohet ndonjë mospërputhje emërtimet që ndeshet aty -</p>

	këtu sidomos tek syllabuset si psh: Master i Shkencave në Financë, Master Shkencor në Shkencat Ekonomike, Master i shkencave në Financë bankë!
Konkluzione: Në hartimin dhe implementimin e këtij program, është mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe i parakushteve të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe Udhëzimeve përkatëse të MASH. Përmbajtja e këtij program studimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MASH.	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;	Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimeve Master shkencor në Financë – Bankë, synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen.
Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	Sipas dokumentave të paraqitur dhe kontakteve me studentet rezulton se vlerësimi i studentëve për ecurinë e tyre por dhe nivelit të asimilimit të dijeve kryhet me anën e provimeve përfundimtare me shkrim që zenë pjesën kryesore të vlerësimit përfundimtar por edhe nëpërmjet detyrave dhe prezantimeve të ndryshme.
Konkluzione: Programi i studimeve Master Shkencor në Financë – Bankë ofrohet në përshtatje me nivelin përkatës të studimeve.	
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane	Ky program merr parasysh në mënyrë të konsiderueshme modelet e ngjashme të ofrura në Francë, Gjermani dhe sidomos vjen në një linjë me kuadrin EMUNI. Në strategjinë afatgjatë të UMSH përcaktohet se ndërmjet aspekteve kryesore të zhvillimeve mesdhetare janë edhe “Rritja e kontributit të UMSH në nxitjen e rolit të Shqipërisë në zhvillimet rajonale, euromesdhetare, evropiane e globale”.
Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;	Nisur nga elementët që ofron shihet se ky program është ambicioz duke synuar të arrijë një nivel konkurrueshmërie sa më të prekshëm ndërkombëtarisht dhe për të afirmuar vlerat më të mira të arsimit universitar në Shqipëri.
Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programi i studimeve Master Shkencor në Financë Bankë është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.
Konkluzione: Programi i studimeve Master Shkencor në Financë Bankë synon të arrijnë dimensione ndërkombëtare dhe të afirmojë vlerat më të mira të arsimit tonë universitar	
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor	

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Programi i studimeve Master Shkencor në Financë Bankë përfshijnë aftësimin profesional me theks të veçantë në kërkimin shkencor në fushën e financës dhe të bankave
Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Programi është hartuar në përshtatje me profilin e UMSH që ka si synim: përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e shkencave ekonomike, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë etj.
Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve. Për këtë dëshmon psh, puna relativisht e lavdërueshme e kryer për përgatitjen dhe botimin e teksteve nga ky personel megjithse veprimtaria e institucionit ka shumë pak kohë që ka filluar.
Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	UMSH është një institucion arsimor i ri që nuk ka patur ndonjë kohë relativisht të gjatë. Megjithatë, puna e deritanishme kërkimore e personelit akademik të angazhuar (efektivë dhe me kohë të pjesëshme) për realizimin e programit të studimeve ka përkuar me synimet e tij.
Konkluzione: Ky program studimeve përfshin kryesisht kërkimin shkencor të fushës por edhe aftësimin profesional të specialistëve të ardhshëm.	
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Megjithse në këtë rubrikë flitet për masterat profesionalë, mund të themi që edhe programi Masteri shkencor në Financë bankë, ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës veçanërisht të institucioneve financiare e bankare
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Besojmë se ky program aktualisht synon të plotësojë nevojat e sistemit financiar e bankar të ekonomisë shqiptare
Konkluzione: Nga përmbajtja e dokumentacionit të paraqitur dhe tregun e punës në vend mendojmë se ky program studimi synon të plotësojë nevojat e sistemit financiar e bankar të ekonomisë shqiptare.	
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Program merr parasysh nevojat e tregut të punës, dhe është hartuar në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar

<p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Nuk gjetëm studime të mirëfillta apo vlerësime të nevojave të tregut të posaçërisht për specialist por, UMSH ka planifikuar të kryej dy studime gjatë vitit 2012 për mundësitë e punësimit të të diplomuarve të rinj dhe për verifikimin e shkallës së punësimit të atyre që do të diplomohen gjatë këtijviti.</p>
<p><u>Konkluzione:</u> UMSH ka menduar e planifikuar të kryej dy studime gjatë vitit 2012 për mundësitë e punësimit të të diplomuarve të rinj dhe për verifikimin e shkallës së punësimit të atyre që do të diplomohen gjatë këtijviti.</p>	
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>	<p>Përmbajtja dhe synimet e këtij programi studimesh nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p><u>Konkluzione:</u> Programi i studimeve “Master shkencor në Financë – Bankë” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni është në fillimet e veprimtarisë së tij. Megjithatë, sipas kontekstit rregullativ, institucioni e bazon vlerësimin e programeve në krahasimin me ecurinë e programeve të ngjashme të studimit në vendet ku u bazua për të hartuar këtë program por e gërshetuar kjo me një konsultim të gjërë me trupën akademike dhe ekspertët më të mirë të fushës</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	<p>Meqenëse ky program por edhe vet institucioni është në vitin e parë, nuk patëm të dhëna për të bërë vlerësimin e plotësimin të këtij kriteri</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>Meqenëse ky program por edhe vet institucioni është në vitin e parë, nuk patëm të dhëna për të bërë vlerësimin e plotësimin të këtij kriteri</p>

<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Meqenëse ky program por edhe vet institucioni është në vitin e parë, nuk patëm të dhëna për të bërë vlerësimin e plotësimit të këtij kriteri. Por, rregulloret e brendshme parashikojnë metodologjinë e vlerësimit dhe përdorimin në të ardhmen të metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit.</p>
<p>Konkluzione: UMSH ka metodologji vlerësimi për ecurinë e programeve të studimeve në të ardhmen si me metoda të drejtpërdrejta edhe të tërthorta të vlerësimit. Ka një kornizë rregullative ku tregohen metodologjitë që përdoren për të gjykuar ecurinë e programeve por dhe instrumentet e vlerësimit. Nuk patëm informacion për të gjykuar nivelin e publikimit të këtij infomacioni.</p>	
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Sipas kornizës rregullative të institucionit, bazuar në vlerësimin e programeve dhe ecurisë së tyre në vende të ndryshme hartohet një plan strategjik për përditësimin e programeve.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Sipas kornizës rregullative të institucionit, bazuar në vlerësimin e bërë për programet institucioni harton plan strategjik edhe në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit</p>

<p>Konkluzione: Sipas kornizës rregullative të institucionit, bazuar në vlerësimin e programeve dhe ecurisë së tyre në vende të ndryshme hartohet një plan strategjik për përditësimin e programeve dhe përmirësimin e të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënimit. Nuk ka nivele të synuara (të përcaktuara) në drejtim të rezultateve të të nxënimit dhe metodave të mësimdhënies</p>	
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimeve “Master shkencor në Financë – bankë” realizohet me 120 ECTS ku 35 kredite janë parashikuar të realizohen në semestrin e katërt për projektin kërkimor dhe mikrotezën. Kohëzgjatja parashikohet 2 vite akademike, (4 semestra)</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Kjo rubrikë nuk ka të bëjë me masterin shkencor.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Kjo rubrikë ka të bëjë programet e integruar</p>
<p>Konkluzione: Kohëzgjatja dhe numri i krediteve të programit të studimeve “Master shkencor në Financë – Bankë” janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Nuk mund të pretendohet ende një standart i tillë meqenëse, ky është viti i parë i këtij program por, UMSH ka programuar këtë veprimtari për të ardhmen nëpërmjet botimit të materialeve informuese etj.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>ky është viti i parë i këtij program por, nga dokumentacioni i shqyrtuar doli se UMSH ka programuar këtë veprimtari për të ardhmen.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni ka programuar publikimin e rregullt të informacionit të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p align="center">II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.</p>	
<p>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</p>	

Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Ky angazhim bëhet edhe në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të institucionit
Konkluzione: Personeli akademik, ndihmës mësimor – shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve	
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Masteri shkencor në Financë – Bankë është i organizuar në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e misionit të tij.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	UMSH ka tre fakultete: Fakulteti i Shkencave ekonomike. Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i diplomacisë dhe Fakulteti i Shkencave politike dhe i Administratës Publike.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Duke u mbështetur në listën e punonjësve akademik dhe të personeli ndihmës del se institucioni plotëson në mënyrë të kënaqshme këtë kërkesë.
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar; Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.	Fakulteti i ekonomisë i UMSH ka tri njësi bazë, prej të cilave dy departamente me misione dhe objektiva të përcaktuar por jo me përbërje të plotë të kërkuar sipas kriterit 5.
Konkluzione: UMSH organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij veçse jot ë gjitha njësitë janë të plotësuara me numrin e kërkuar të personelit akademik të kërkuar sipas kriterit 5.	
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij
Konkluzione: Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve si dhe l njojin mirë përgjegjësitë e tyre në lidhje me rekrutimin e personelit akademik të nevojshëm për realizimin e programeve.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në	Hartimi i kurrikulës së këtij program studimi është

hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e stafëve akademike të brendshme dhe të jashtme
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në, GVJ nuk arriti të identifikojë ndonjë mospërputhje me këtë kriter
Konkluzione: Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit	
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Ky program studime zhvillohet në godinën e institucionit të marrë me qera në të cilën zhvillohet veprimtaria mësimore dhe ndodhet edhe mjedisi qendror administrativ
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Mjediset janë marrë në qera për një periudhë 10 vjeçare
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Të gjitha veprimtaritë e mësimdhënies apo veprimtari të tjera të këtij program studimi zhvillohen në të njëjtën godinë duke siguruar në këtë mënyrë një kontroll të vazhdueshëm dhe menaxhim efikas
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Ky program studimi nuk ka veprimtari të tilla me përjashtim të praktikave profesionale që, tani për tani, kryhen pranë qendrave të punës të studentëve që njëkohësisht punojnë në qendra të ndryshme si banka etj,
Konkluzione: UMSH siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programit të studimeve “Master shkencor në Financë – Bankë”.	
Standardi II.6 Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve .	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Informacioni i ofruar për programin e studimeve “Master shkencor në Financë – Bankë”, modulet dhe syllabuset janë lehtësisht të konsultueshëm për studentët;
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Programi studimit, modulet dhe syllabuset publikohen në formë broshurash dhe u ofrohen studentëve edhe elektronikisht.
Konkluzione: UMSH siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programin e studimeve master	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Korniza rregullatore e institucionit, parashikon analizën vjetore për vlerësimin dhe ecurinë e programeve. Historiku i shkurtër i këtij institucioni nuk na dha mundësi të vlerësonim plotësimin e këtij kriteri.
Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të	Korniza rregullatore e institucionit, parashikon hartimin e politikave të tilla

dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Konkluzione: Sipas kuadrit rregullues të UMSH, parashikohet analiza vjetore për vlerësimin dhe ecurinë e programeve si dhe hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e tyre por, për shkak të historikut të shkurtër të këtij institucioni nuk kishte mundësi vlerësimi për shkallën e vënies në zbatim.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Është viti i parë i studimeve në këtë Master shkencor megjithatë në dokumentacionin e institucionit është parashikuar mënyra e diplomimit.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave në Financë - Bankë” janë parashikuar 35 ECTS për projektin kërkimor punën praktike dhe përgatitjen e mikrotezës.
Konkluzione: Programi i studimeve “Master i Shkencave në Financë – Bankë” parashikojnë planin e diplomimit	
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, në momentin e vlerësimit, rezulton se institucioni ishte në mes të një procesi auditimi të pasqyrave financiare. Audituesi i jashtëm është shoqëria AIEI Auditors.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Për sa kohë që UMSH kalon procesin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare në mënyrë deductive pranojmë se raporti do të përmbajë grantet e përfituara apo kontratat e shërbimit për realizimin e programeve.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Gjithashtu në mënyrë besojmë se ky informacion do të jetë pjesë e Raportit të auditimit
Konkluzione: UMSH i nënshtrohet procesit të auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare cdo vit. Ky proces auditimi nënkupton plotësimin e kriterëve të këtij standardi.	
III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Kuadri rregullativ përmban rregulla ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Kuadri rregullativ përmban procedura transparente të vlerësimit të personelit
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Institucioni ka bazë të dhënash për procesin e rekrutimit të personelit
Konkluzione: UMSH ka rregulla dhe procedura mjaftueshmërisht transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. Për pjesën e procedurave të kryera ka një bazë të plotë të dhënash për këtë proces	
Standardi III.2 Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Ka përgjegjës për programet e studimit Master me gradën PDH të fituar në një universitet të huaj dhe përvojë akademike në këtë universitet.
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Titullarët e lëndëve të programit kanë gradën shkencore “Doktor”. Kjo dëshkohet nga lista e titullarëve të lëndëve.
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Kjo rubrikë i referohet masterave profesionale.
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Listat e të përsuarve të këtij institucioni dëshmojnë për plotësimin e këtij kriteri.
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Për numrin aktual shumë të vogël të studentëve në masterin shkencor të fiancës, institucioni ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale
Konkluzione: Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë	
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Megjithse është një institucion i ri ai ka parashikuar të organizojë veprimtari akademike në funksion të programeve me synimin për të përfshirë stafin akademik dhe studentët në projekte kërkimore, seminare, konferenca etj dhe për t’i publikuar në revistën shkencore të UMSH. Deri tani kjo revistë (Euromediterranean) ka botuar numrin 1/ 2010 dhe 2/ 2011. Përveç kësaj, UMSH është pjesëmarrës dhe organizator e botimit “Proceedings 6th International Conference of Albanian Institute of Sociology” të 21 – 22 nëntorit 2011.

Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.
Konkluzione: Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	UMSH ka synimin të organizojë leksione publike ose module të veçanta me personel akademik të ftuar në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjerë.
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Ende kjo veprimtari mbetet si projekt dhe synim ambicioz i UMSH
Konkluzione: Institucioni ka parashikur të ofrojë mësimdhënie edhe në gjuhë të huaj por, tani për tani, mbetet si projekt dhe synim ambicioz	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Jemi ende në fillimet e këtij programi por, është programuar që, me fillimin e semestrit të fundit, çdo student bashkë me udhëheqësin e zgjedhur prej tij, të hartojë planin e diplomimit me afate e ngazhime konkrete
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Udhëheqësi është programuar të ketë paktën gradën shkencore “Doktor”
Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Parashikohet që, në muajin korrik 2012, të përcaktohen udhëheqësit e temave duke respektuar kufijtë pakatës të numrit maksimal të lejuar të studentëve
Konkluzione: Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, mendojmë se institucioni jep garancitë e nevojshme për respektimin e kërkesave ligjore e rregullative për përcaktimin e udhëheqësve të mikrotezave të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”.	
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Gjykuar nga lista e personelit të aktivizuar ose të projektuar për t’u aktivizuar në procesin mësimor e kërkimor dhe nga numri aktual i kufizuar i studentëve të programit ka udhëheqës të mjaftueshëm për këtë qëllim. Sipas anketës së organizuar me këta student nga APAAL doli se studentët ende nuk janë njohur me temat e

	mikrotezës.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Udhëheqësit e parashikuar kanë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore të fushës.
Konkluzione: Lista e personelit të aktivizuar ose të projektuar për t'u aktivizuar në procesin mësimor e kërkimor dhe numri aktual i kufizuar i studentëve të programit bëjnë që ky kriter të plotësohet mirë.	
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor – shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor – shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Programi i studimit Master shkencor në Financë – Bankë, nuk parashikojnë orë laboratorike por, UMSH ka mjedise dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e tyre;
Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	
Konkluzione: Programi i studimit Master shkencor në Financë – Bankë, nuk parashikojnë orë laboratorike por, UMSH ka mjedise dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e tyre.	
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	UMSH ka të dhëna për personelin e angazhuar në programin e studimit
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin master vlerësohet me orë mësimore
Konkluzione: Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi	
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Të dhënat e paraqitura nga institucioni dëshmojnë për përputhshmëri të mjaftueshme me këtë kriter.
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	Të dhënat e paraqitura nga institucioni dëshmojnë se ai ka listën e plotë të personelit akademik e ndihmës të mjaftueshëm
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni ka të dhëna për kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik
Konkluzione: Të dhënat e paraqitura nga institucioni dëshmojnë se ai ka bazën e të dhënave dhe një listë të plotë të personelit akademik e ndihmës të mjaftueshëm.	
Standardi III.10	

- Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Nuk mund të shprehemi për përputhshmërinë e plotë të këtij kriteri për shkak të historikut të shkurtër të institucionit
Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Nuk mund të shprehemi për përputhshmërinë e plotë të këtij kriteri për shkak të historikut të shkurtër të institucionit
Konkluzione: UMSH ka politika të qarta angazhimi në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij akademik, të cilat duhet të gjykojnë në kohë për zbatimin e tyre dhe efektet që mund të sjellin në drejtim të përmirësimit të programeve të studimit dhe jo vetëm. GVJ nuk mund të shprehej për përputhshmërinë e plotë të këtij standarti për shkak të historikut të shkurtër të institucionit	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore -shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	UMSH ka të dhëna për studimet shkencore të personelit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Nisur nga vizita e në bibliotekë GVJ ve re se UMSH ka të dhëna të hollësishme për botimet brenda dhe jashtë vendit
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	UMSH është një institucion i ri. Megjithatë, ai disponon një bazë modeste të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.
Konkluzione: Megjithatë, nga vizita e në bibliotekë GVJ ve re se UMSH ka të dhëna të hollësishme për botimet brenda dhe jashtë vendit	
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave në Financë Bankë” kanë diploma universitare “Bachelor” ose diplomë katërvjeçare dhe kanë grumbulluar 180 ECTS
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Nuk i referohet masterit të shkencave në Financë – bankë.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura	Studentët janë të informuar se deri në fund të këtij programi studimi duhet të japin provim gjuhën angleze të nivelit përkatës. Por, ky kriter mbetet

<p>ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve; Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>përt’u parë në të ardhmen meqenëse ende nuk ka të diplomuar nga ky program. Studentët aktualë janë në vitin e parë të studimeve</p>
<p>Konkluzione: Ky kriter, në parim respektohet por mbetet për t’u parë realizimi kur të përfundojnë studimet studentët e parë të këtij program master në shkencë.</p>	
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>Në UMSH funksionon Zyra e Këshillimit të karrierës dhe ka disa funksione kryesore të përcaktuara ndërmjet të cilave edhe informimi i studentëve për mundësitë e punësimit pas diplomimit.</p>
<p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky insttucion;</p>	<p>Sipas rezultateve të anketës së organizuar nga APAAL, 83% e studentëve theksuan se: UMSH ka caktuar një pedagog përgjegjës me të cilin këshillohen për hapat e ndryshëm dhe vështirësitë që hasin gjatë periudhës së studimit.</p>
<p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në UMSH funksionon Zyra e Këshillimit të karrierës dhe ka disa funksione kresore të përcaktuara ndërmjet të cilave edhe informimi i studentëve për mundësitë e punësimit pas diplomimit.</p>
<p>Konkluzione: UMSH informon studentët për statusin e institucionit, programet e studimeve që ofron dhe politikat e punësimit</p>	
<p>Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p>UMSH po aplikon për herë të parë</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p>UMSH po aplikon për herë të parë por ka të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë</p>
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>UMSH po aplikon për herë të parë por ka të dhëna për ecurinë e deritanishme</p>
<p>Konkluzione: UMSH po aplikon për herë të parë në këtë program studimi por ka të dhëna për për numrin e studentëve të regjistruar dhe për ecurinë e deritanishme të tyre.</p>	

Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	UMSH po aplikon për herë të parë
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	UMSH po aplikon për herë të parë
Konkluzione: Nuk ka të dhëna sepse UMSH po aplikon për herë të parë në këtë program studimi	
Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Studentët e këtij programi informohen hollësisht për programin e studimeve organizimin, afatin e përfundimit dhe statusin e akreditimit të programit.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Nuk gjetëm të dhëna për këtë por, nga intervista me studentët doli se 100% e tyre janë të kënaqur me organizimin dhe format e avancuara të mësimdhënies.
Konkluzione: UMSH informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të hollësishme për programin e studimeve	
Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Nga intervista doli se 83% e studentëve theksuan: UMSH ka caktuar një pedagog përgjegjës me të cilin këshilloheni për hapat e ndryshëm dhe vështirësitë që hasin gjatë periudhës së studimit.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës UMSH ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.
Konkluzione: UMSH angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve	
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	UMSH siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore. Nga ana tjetër, edhe pse institucion i ri, po bën një punë të lavdërueshme për përgatitjen dhe botimin e teksteve të tij.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses	Biblioteka e UMSH ka literaturë të mjaftueshme për realizimin me sukses të programit të studimit,

të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Biblioteka e UMSH ka periodikë dhe librari elektronike të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	UMSH ka programuar blerjen e përvitshme të një fondi librash me vlerë rreth 500.000 lekë.
Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Biblioteka ka orare të përshtatshëm shërbimi me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve
Konkluzione: UMSH ka dhe ve në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshëm mësimorë.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	UMSH ka në sasi të mjaftueshme laboratorësh, klasash, zyrash, pajisjesh elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve
Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Pajisjet e mjediseve mësimore të UMSH janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit
Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen;	Laboratori i UMSH ka aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve. Kurse, për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, nuk ka ndonjë laborator. Për shkak të veçorive që ka ky program i fushës së shkencave shoqërore, praktika zhvillohet jashtë institucionit.
Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	UMSH ka një laborator PC në dispozicion të studentëve
Konkluzione: UMSH ka në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise mësimorë të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm	
Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Është për Masterin Profesional
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në	Për kryerjen e praktikave të parashikuara për

<p>programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>realizimin e programit të studimeve “Master në Financë – bankë” UMSH ka marrëdhënie bashkëpunimi me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dhomën e tregtisë dhe të Industrisë Tiranë, - Aleanca e Biznesit të Kosovës, - Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave të Shqipërisë
<p>Konkluzione: Për kryerjen e praktikave të studentëve të tij UMSH ka marrëdhënie bashkëpunimi me: Dhomën e tregtisë dhe të Industrisë Tiranë, Aleancën e Biznesit të Kosovës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Shoqatën e Bankave të Shqipërisë.</p>	
<p>VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE</p>	
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;</p>	<p>Nisur nga parimi I besimit, gjykojmë se institucioni ka analiza të thelluara të kostove të çdo veprimtarie për përmbushjen e detyrimit të ofrimit të studimeve të ciklit të dytë</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>UMSH është një institucion i ri por, nisur nga parimi i besimit, gjykojmë se ka analiza të thelluara të kostove të çdo aktiviteti në funksion të përmbushjes së detyrimit të ofrimit të studimeve të ciklit të dytë</p>
<p>Konkluzione: UMSH ka një përdorim të kënaqshëm të informacionit për qëllime të vendimarrjes por, përderisa informacioni i kosto-drejtimit është vetëm për drejtimin dhe nuk mund të vihet në dispozicion të të huajve nuk patëm aksesin e nevojshëm për vlerësim. Vlerësimi jonë u bazua në parimin e besimit dhe në dokumentacionin e VGB të institucionit.</p>	
<p>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</p>	
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, UMSH nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nëpërmjet ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, UMSH garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi</p>
<p>Konkluzione: UMSH garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet</p>	
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>Institucioni ka marrveshje bashkëpunimi me institucione homologe të vendit dhe të huaja</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie</p>	<p>UMSH vendos marrëdhënie bashkëpunimi me</p>

bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Organizohen trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Si institucion i ri ende nuk ka patur rastin të kryej këtë.
Konkluzione: Kuari rregullues, marrëveshjet e deritanishme dhe ekipi garantojnë garantojnë marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	UMSH ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit “Master shkencor në Financë – bankë”.
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	UMSH kontrollin e brendshëm e realizon nëpërmjet specialistëve të Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave.
Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	UMSH ka një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre kryesisht nëpërmjet funksioneve të përcaktuara të Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Rezultatet e kontrolleve të kryera nga Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave bëhen objekt diskutimi në mbledhjet e departamenteve deri në Senat.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	UMSH synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	UMSH ka politika dhe strategji të publikuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
Konkluzione: UMSH garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimeve në Masterin Shkencor në Financë – Bankë.	

Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit

Pikat e forta

1. Orientimi i spikatur i këtij masteri nga kërkesat e institucioneve financiare e bankare.
2. Kushte të mira infrastrukturore (laboratorë dhe mjedise mësimore bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor dhe të veprimtarive të tjera).
3. Strategjia e hapjes ndaj bashkëpunimit dhe partneritetit.

4. Prania e një bërthame ekipe akademike dhe drejtues me përvojë të spikatur në fushën e arsimit të lartë por edhe në drejtimin ekonomik e financiar të ekonomisë Shqiptare.

Pikat e dobëta

1. Programi studimi i ri ende i pakonsoliduar dhe me reputacion relativisht të panjohur meqenëse është viti i parë i studimeveⁱ
2. Numri relativisht i madh i personelit mësimdhënës të angazhuar me kohë të pjesës hme.

Kërcënimet

1. Numër relativisht i kufizuar studentësh dhe cilësi relativisht e ulët e prurjeve
2. Rritja e ardhshme e mundshme si nga pikëpamja e numrit të studentëve edhe nga pikëpamja e zgjerimit, kërcënohet nga hapësirat relativisht të kufizuara dhe nga numri i kufizuar i personelit efektiv.

Oportunitetet

1. Lidhjet e forta dhe bashkëpunimi institucional me shumë universitete evropiane sidomos mesdhetare meqenëse UMSH është anëtar i EMUN (rrjet i universiteteve të Mesdheut) dhe i mazhi shumë pozitiv tek bashkëpunëtorët e jashtëm.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit me institucionet e biznesit vendas e kosovar sidomos për kryerjen e praktikës profesionale.

Rekomandimet

1. Shtimi i numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe plotësimi i mëtejshëm i strukturave përkatëse universitare si department, etj.
2. Për programet e lëndëve GVJ sugjeron:
 - a. Në lëndën Metodat e kërkimit shkencor, të plotësohet shpërndarja e ngarkesës në auditor dhe emri i pedagogut
 - b. Në lëndën "Strategjitë e Marketingut bankar", duhet ndryshuar literatura bazë meqenëse ajo që shënohet në program është më shumë për Strategjitë e Marketingut në përgjithësi. Edhe literatura e huaj e përmendur në program përfshin: Marketing Management dhe Foundation of Marketing.
 - c. Në lëndën "Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare" duhet saktësuar emërtimi meqenëse programi flet më shumë për "Manaxhimin strategjik" në përgjithësi se sa për manaxhimin strategjik të Institucioneve financiare. Po kështu duke saktësuar titullari i lëndës (E. Leskaj apo D. Salko)
 - d. Duket se programi i lëndës "Financat e korporatave" përsërit në një shkallë shumë të madhe "Drejtimin Financiar Ndërkombëtar". Kjo shihet jo vetëm nga përmbajtja e syllabusit por edhe nga literatura bazë (Alan C. Shapiro – Multinational Financial Management, Jeff Madura – Drejtimi Financiar Ndërkombëtar dhe H. Xhafa – Drejtimi Financiar Ndërkombëtar). Mund të përmirësohet programi ose të ndërrohet lënda.

- e. Në lëndën “Kontabiliteti Financiar – Standartet Ndërkombëtare”, duhet saktësuar emri i pedagogët përgjigjës dhe literature bazë (Si literaturë bazë nuk mendojmë se mund të jenë “Legjislacioni tatimor Shqiptar” – S. Dharmo dhe as “Përmbledhje e Legjislacionit – botim i DPT! Kontabiliteti financiar dhe Standartet Ndërkombëtare janë tjetër gjë megjithse lidhen edhe me legjislacionin!
- f. “Metodat bashkëkohore të Analizës Financiare”: duke u nisur nga përmbajtja e programit dhe nga literature e rekomanduar krijohet përshtypja sikur janë njohuri të nivelit bachelor. Nuk e di nëse janë në planin përkatës mësimor. Nëse shtjellohen për herë të parë nuk përbën problem. Po ashtu duhet mënjeluar një mospërputhje e rrjetit të orëve sipas planit mësimor (3/3) me rrjetin e orëve të parashikuar në syllabusin përkatës (2/2).
- g. “Menaxhimi Bankar” dhe “Kreditimi dhe Analiza e kredisë” kanë program të ngjashëm që, pjesërisht, mund të argumentohet se janë lëndë me zgjedhje të njera tjetrës. Më mirë do ishte të vendosej një disiplinë tjetër! 3/3 apo 2/2.

Në përfundim të këtij raporti, GVJ mendon se, në përgjithësi, programi i studimit “Master Shkencor në Financë – Bankë” i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, **përmbush kërkesat e standarteve kryesore në tërësi.**

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm

1. Prof. Dr. Lavdosha **ZAHO**

ⁱ Nga anketimi i studenteve rezultoi si një nga pikat e dobëta fakti që institucioni “nuk është institucion i njohur në tregun e punës”.